

ESAT CËRMJANI  
NGJYRAT E JETËS  
POEZI

Lektor – korrektor:  
Shefki Oseku

Përpunimi kompjuterik:  
Frashër Oseku

U dorëzua në shtyp në nëntor të vitit 2001

U botua me ndihmën e ABF-it në Treleborg-Suedi

Tirazhi:  
1.000 copë

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELLEBORG - Suedi

## MES ËNDRRËS E ZHGJËNDRRËS

Në vegjëli besoja se do ta bëj botën ashtu si dua vet:  
Pa shpirtëra të shtypur, pa lypssarakë, pa ushtarë...  
Por, prej krejt kësaj tani, veç një ngushëllim më ka mbet'  
- Të paktën të krijoj diçka si vjershëtar.

**NJË JETË**

## LINDJA

- Qoftë si baba! – thuhet kur lind djalë  
E, për vajzën - qoftë si nëna!  
Duke dëshiruar që si të tillë në jetë të vlejnë.

Por, i poshtri, tradhtari apo hajni mbi hajna  
Vallë, a dëshiron që fëmija i tij si ai me qenë?

## KËNGËTARI

Për t'i dehur zemrat ka ardhur këtupari  
Dhe, pastaj të kthehet me të shpejtë  
Secilit në shpirt nga një këngë t'ia vari  
- Dhuratën e tij më të shtrejtë.

## RINIA

T'i shkrijmë buzët në puthje, o vajzë!,  
e shpirtin në këngën e paanë  
Kurse gjithçka tjetër le ta harrojmë, në daçim?;  
Se vdekjes askush s'ka mundur me iu shmang  
Ndaj, të paktën, këtë qenien e sotme ta kënaqim

## PREMTIMI

- Do të vdes me syt e tu në buzë e gjinjt në du'r!-  
I panjohuri premtueshëm më pat thënë.  
Por, pas epshit iku, ndërkaq unë e pikëlluar ngela nën urë  
Së bashku me tingëllimën e të hollava që i pat lënë.

## LAVIRJA

- Mos më kafsho edhe ti, të lutem,  
Por shtrëngom e puthëm sa të du'sh!  
Se, po të kisha vepruar kështu edhe më parë,  
Tani, mbase, do t'më dashuronte dikush!?



## MASHTRIMI

- E dashuroj një vajzë!–tha një djalë bukur i rritur.  
Dashnore të tillë askush nuk ka!  
Madje, do të martohesha me të, foli i mahnitur.  
Por, tinëza pëshpëriti: - veç në film e kam pa’.

## MËKATI

- Të ka vdekë babai, shoqe, mos u mërzitë!

Dikush vajzës në lulishtë i tha.

Ajo veç shikoi, dhe djalit edhe më fort për trup iu ngjit

Megjithatë, sa mëkat! më vonë mu ai djalë e la.

## TRADHTIA

Pse vajzë, çka gjete në qenien e tij  
Më të madhe se dashurinë time;  
Apo tashma t'u mërzhitën sytë e mij  
Që s'dijtën, si tuajt, mashtrime?

## TAKIMI I RASTIT

Në tren

E dij se kurrë më unë nuk kam me të parë!

- Më mirë, ndoshta, fare të mos ishim takuar

Sepse, kend mund ta bëjmë fajtor që patjetër duhet ndarë

Tash, kur kaq fort të kam dashuruar?

Në liqe

Sa herë të lundrosh liqenit, kujtoje këtë mbramje  
Dhe puthjen, po edhe këtë barkë të vjetër!  
Se gjë më e ëmbël s'na mbetet në këtë ndarje  
Nëse tash e tutje nuk i shkruajmë njëri-tjetrit letër.

## NDARJA

-Lamtumirë, deri në verën e ardhshme  
Kur do të takohemi përsëri në verime!  
Por, unë s' do kthehem më në pushimoren e mëparshme  
Ku më mbetën vetëm kujtime.

## MËRGIMI

- Ja, këtë fotografi dhe mos vajto pas meje!  
Sepse jeta duhet të vazhdojë...  
Kupën e kujtimeve tona pa dhembje-thyeje!  
Që ndarja, vërtet, të na harrojë.

## KËNGA

Në sytë e asnjërit nuk mund të vërejsh gja  
Apo zemrën me ia çelë se – vdes!  
Kur don ta dijsh se çfarë shpirti ka  
Atëherë, pyete, se vetëm kënga e tij të tregon–në besë.



## JETA

Nuk e di a do të mund të qaj në vdekjen e babës,  
Apo ta kundërshtoj dashurinë e gruas me një tjetër burrë,  
Nuk e di, kur të vdes, sa do t'i dhembsem nanës  
Por jeta – kjo tashmja - e di: nuk përsëritet më kurrë.

## VDEKJA

-Vetëm edhe një puthje, nuk më duhet tjetër  
As më shumë se dy pika lot - për mua.  
Tani më gjithçka është mashtrim i vjetër  
Sa edhe premtimi: "Kemi për t'u takua"...

## NGUSHËLLIMI

- Mos, qani, fëmijët e mi, mos vajtoni  
Se varri i nënës s'do të mëshirohet-aspak  
Por, hidhni valle rreth tij dhe këndoni  
Që helmi kurrë mos t'u rrjedhi në gjak.

## EPITAF

Një nëne të re-  
së cilës iu duk e turpshme që kishte mbetë shtatzënë!?

” I deshi njerëzit dhe jetën“! mund të thuash, o kalimtar

”Meqë për ëmbëlsinë e tyre krejtësisht u bind.

E deshi nënën e vet, si rrallë ndonjë djalë!”...

Por, mashtrohesh... ngase ajo nuk e la, madje as të lindë!?

ME PIKË NË ZEMËR

## PA TITULL

Shikoj yjet dhe e di që kurrë s'do të mund t'i prekë

- Sa të pamundshëm jemi ndaj gjithësisë!

Po, vallë, sa të tjerë, të panumërt, kanë vdekë

Sikurse thonë:- "Pa e kaluar, madje, as pragun e shtëpisë"!?

## SIMPTOM I KOHËS

-Flet Andaluzija-

Ta shikosh jetën drejtë në sy

Të verbon me ngjyrat e veta.

Por, shëmtim edhe më i madh është pas shpine me i hy'

Duke thënë me shpoti: - Kjo është ajo e vërteta!

## KËNGA E PENGUAR

Gjithmonë kam dashur  
Të këndoj për diçka  
Por, uni im asnjëherë këngën  
Të dalë jashtë s'e la.



## PËR KËNGËN E DËSHIRUAR

Më së afërmi e kam unin tim, dhe atë e dua  
Aq sa të vërtetën, ose vdekjen e bardhë.  
Por, unë patjetër kallshëm do t'isha flijua'  
Për këngën, që dëshiroj me ardhë.

## PARAKËNGA E DËSHIRUAR

Kisha dashur t'i kem shtatë zemra dhe shtatë gjuhë dhunti  
Ta ndjej dhe ta shprehi bukurinë e Dukagjinit tim...  
Kisha dashur shumë... po, vallë, a do t'kem mundësi  
T'i thoja gjithë ato që ky viga po i rritë nën kësulen e fisit tim?

## URA E FSHENJT

Drini i Bardhë shekuj me rradhë do të rrjedhë, pa u ndalur fare  
Duke i kaluar të panumërat presa dhe penda...  
E njerëzit do të lindin... do të vdesin... ah! jeta jonë kalimtare!  
Po, Urën e Fshenjt në gjirin e ngrohtë ka për ta ruajtur-  
legjenda.

... E VALA ARRINË EDHE TE ZEZAKU

O valë e prrockës! që po ecën fare ngadalë  
E urtë dhe skofiare, si poezia e dashurisë  
- Jepe kushtrimin atje, ku ti ke me u ndalë:  
Se hareshëm po i fërkon sytë mëngjesi i Lirisë.

## GJENERATË E NDRITSHME

Në mesin tonë, po ndjej se do të lindin, patjetër  
Të flaktë, disa poetë dhe shkrimtarë të rinj  
Të cilët zemrat e ngrira të kësaj toke të vjetër  
Me zjarrin e fjalës së vet kanë me i shkri’.

## LINDËM ME GËRMADHAT

Shokëve të mi, vjershtarë

Nëpër mote poezia jonë do të bëhet e vjetruar, si i vjetri hon  
Muzeumi i saj, besoj, i çuditshëm ka për të qenë.

Por, breznitë do të vërejnë diçka që parreshtur do t'i shqetëson  
Ashtu siç shohin hare dhe gaz në të renë.

## DASHURIA E PARË

Kurrjë e rëndësishme s'do të ndodhë në përvjetorin  
e vdekjes sime

As, nëna prej dëshpërimit ndoshta nuk do të plasë;  
Por Lires, së shpërngulur, gjithmonë do t'i ngjallet  
në kujtime

Shoku, që dikur e kishte në klasë.

## KURRË NUK THUHEN TË GJITHA

Kur shikohem në pasqyrë, shpesh hija më thotë:  
„Ti shumë po flet, madje më shumë për veti!“.  
Kujtoj se një ditë, me siguri do t’i them, si sot:  
- Megjithatë, shumëçka pa thënë më mbeti.



## FJALA

- Fjala qenka e vogël dhe e pamundshme për hallet e mëdha të botës.

U nisa prej vetvetes, dëshirëgur, për t'u bërë vjershëtar  
Ëndrova për të arritur në majat më të larta të poezisë...  
Por, po e shoh se dëshira do të më mbetet veç dëshirë,  
si më parë  
Dhe kurrë s'do të mund ta prekë, edhe ashtu të plagosur,  
zemrën e njerëzisë.

## SHPIRTI PRAPSEPRAPË NUK HESHTI

Nuk munda ta krijojë poezinë që aq gjakueshëm  
ia dhash detyrë vetit

Dhe kështu, i thyer, ka kohë që unë heshta.

Vërtetë: çfarëdoqoftë ajo, a mundet njeriu ta prekë e nxitë  
zemrën e tjetrit

Vetëm me të shkretët-katër rreshta!?

DHE LOT NË NDËRGJEGJE

## VJESHTA

Në ballkonin e spitalit qëndronte djali me sëmurje  
të pashërueshme  
Dhe pikllueshëm e shikonte fluturimin e dallëndysheve,  
të shpejta si era.  
Dallëndysheve të lumtura, dallëndysheve të gëzueshme...  
-„Vallë, a do ta presë kthimin e tyre, kur sërish do të vijë  
pranvera?”...

## PRANVERA

Dhe, ja, pranvera erdhi e dushku blerohet malit.  
Edhe dallëndyshet e lumtura janë kthy'.  
Por, kurrkush më s'shihet në ballkonin e spitalit,  
Ndonëse me mall të madh e kërkojnë dy sy.

## E PAMENDUARA

Bien gjethet e thara të dushkut aty-ku dy muaj më parë  
Djaloshi gëzueshëm i fliste dashnores së vet:

- Edhe verës tjetër në këtë kodër do të vijmë, të pandarë!...

Ja, tani vjeshta ka ardhur e mbi varr të djalit bari është  
zverdhur krejt.

## DASHURIA

- Për dashurinë, fjalët e mëdha dhe premtimet nuk janë masë. Ato nxisin vetëm dyshime.

Po ta donim njeriun për së gjalli aq sa na dhembset pas  
vdekjes

Besoj se gjithkush e di se çfarë do të jetë pasoja.

(Vallë, sa zgjatë dashuria e vërtetë gjatë jetës?)

Sepse, ti thuash njeriut: "Të dua fort"!—askujt s' do t'i  
dhembte goja.

## PIKËLLIMI PËR TË PAMUDSHMEN

- Po ndjej se më është bë e domosdoshme të të gjejë, së paku në dikend tjetër. Por, a mund të ngjajë në botë diçka e tillë?

Për ty, motër, më së miri e më së kallshmi do të kisha kënduar  
Besoj se edhe ti vet do të ishe bindur.

Gjatë do ta mendoja fjalën dhe rreshtin për t'ia filluar:

- Motër... Por, medet! sepse ti fare nuk ke lindur.



## NE TË TRE

Kam shkruar elegji për shokun tim të vdekur  
E dashnoren më pas të çmendur ia kam parë.  
(Dikush po bëhet poet, ndërkaq tjetri nën dhe ka tretur!?)  
I çuditshmi fat: në lindje e vdekje na u bëka kumbar!

## KËTO GJITHMONË HARROHEN

O ditë, që po shkon e s'kthehesh më, as pas një viti  
Ditë, që si shenjë se ishe - këtë këngë mitare po ma lë  
-Me çka të të kujtoj, pasi që kujtim tjetër s'më mbeti?  
Me çka?... Se në djep të këngës, ndofta edhe e nesërmja  
do të më vë?

## PYETJE

Ndërsa shkruaja: ç'm'u desh të vija në këtë botë?

Pse, vallë, a fare s'bënte bota pa mua?

Befas në veten time një zë i qetë u dëgjua:

-Gjithkush, o marroq! për diçka ka lindur, qoftë edhe për kot!

## NË ÇASTE TË ERRTA

Pak po më dhembshesh që heret kam me të lënë, o jetë,  
Ka kohë që më je bë e bezdisshme, ti përditshmëri.  
Rini djerrakohëse: sheti poshtë e përpjetë...  
O vdekje tinëzare! o poezia ime-pa trashëgimi?

## DITA E FUNDIT

Njërën ditë gjithmonë në mend do ta mbaj  
Edhe pse cila do të jetë ajo-unë nuk e di  
E, një ditë–më nuk do të jam në të nesërmen e saj...  
Pra, e fundmja ditë, megjithatë do të më arrijë.

PABESUESHMËRIA PËR DIÇKA  
QË PATJETËR DO TË VIJË

Po ndjej se çdo këngë po ma vjedhë nga një grimcë  
të zemrës sime  
Dhe vetëm dhembje e plagë në të prore po më hap  
Po ndjej kështu dhe pyes: vallë, s'do të mbesin më  
as thërrime  
Për këngët e vonuara, për moshën që po vjen me vrap?

---

Të gjitha poezitë e mësipërme janë shkruar  
në Gjakovë-Kosovë, gjatë viteve 1961-1964.

## LUTJE NËNËS

Nëna ime-afrohu të të puthë  
si tokën që puthja në vegjëli, e ti s'më lije

Nëna ime-krihmi kaçurrelat  
pa le të qaj, si dikur kur duarëve më bije

Nëna ime-tregoma atë të bukurën legjendë  
për Mujën e Halilin, si kur flija pranë sofrës bosh

Nëna ime-që t'i numëroj rrudhat në ballë  
e thinjat në kokë-a do të më lejosh?

Nëna ime-të lutem, fole veç një fjalë  
të mos e harroj zërin tënd, që moti s'e kam ndi'

Nëna ime-oh, ti je kaq larg  
kur duhet t'ishim afër - por unë prapë do të vij

Do të vij patjetër Atë Ditë  
dhe ty gjallë a të vdekur do të gjejë

Në daç-mos m'i trego vuajtjet që ke heq  
as unë mallin s'do ta rrëfej

Në daç-mos m'i ledhato flokët  
se tanimë kaçurrelat e tyre kanë tretë

Në daç-mos ma trego të bukurën legjendë  
se zemrën do ta kem të plotë-si lisi me fletë

Në daç mos më lë t'i numëroj thinjat e rudhat  
se mund të më shpëtojnë dhe lot

Në daç mos ma fol asnjë fjalë  
se zërin tënd s'e harroj dot

Në daç mos më lë të të puthë  
se as për këtë keq s'do të më vijë

Por, të lutem, o nëna ime! më lë ta puthi tokën  
e të ngopem me atë si dikur, në vegjëli.

---

Kjo poezi u shkrua në gusht, 1966,  
në Goranxi-Gjirokastër, Shqipëri.



# ESAT CËRMJANI

## NGJYRAT E JETËS POEZI

Lektor – korrektor:  
Shefki Oseku

Përpunimi kompjuterik:  
Frashër Oseku

U dorëzua në shtyp në nëntor të vitit 2001

U botua me ndihmën e ABF-it në Treleborg-Suedi

Tirazhi:  
1.000 copë

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELLEBORG - Suedi

## MES ËNDRRËS E ZHGJËNDRRËS

1. LINDJA
2. KËNGËTARI
3. RINIA
4. PREMTIMI
5. LAVIRJA
6. MASHTRIMI
7. MËKATI
8. TRADHTIA
9. TAKIMI I RASTIT;
10. NË LIQE
11. NDARJA
12. MËRGIMI
13. KËNGA
14. JETA
15. VDEKJA
16. NGUSHËLLIMI
17. EPITAF

## ME PIKË NË ZEMËR

18. PA TITULL
19. SIMPTOMI I KOHËS
20. KËNGA E PENGUAR
21. PËR KËNGËN E DËSHIRUAR
22. PARAKËNGA E DËSHIRUAR
23. URA E FSHENJT
- 24... E VALA ARRINË TE ZEZAKU
25. GJENERATË E NDRITSHME
26. LINDËM ME GËRMADHA
27. DASHURIA E PARË
28. KURRË NUK THUHEN TË GJITHA
29. FJALA
30. SHPIRTI PRAPË NUK HESHTI

## DHE LOT NË NDËRGJEGJE

31. VJESHTA
32. PRANVERA
33. E PAMENDUARA
34. DASHURIA
35. PIKËLLIMI PËR TË PAMUNDSHMEN
36. NE TË TRE
37. KËTO GJITHMONË HARROHEN
38. PYETJE
39. NË ÇASTE TË ERRTA
40. DITA E FUNDIT
41. PABESUESHMËRIA PËR DIÇKA QË PATJETËR DO TË VIJË
42. LUTJE NËNËS



## ESAT CËRMJANI

Esat Cërmjani u lind në Gjakovë, më 09.06.1944. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Qysh në vitin e parë të gjimnazit „Hajdar Dushi“ , në Gjakovë, arriti t'i botojë poezitë e para në revistën e mirënjohur „Jeta e re“, në Prishtinë. Në klasën e tretë të gjimnazit, pra që në vitin 1964, Esati e kishte të gatshme për botim përmbledhjen me vjersha: „Ngjyrat e jetës“, të cilën me përkushtim, ia kishte lekturuar i ndjeri, Rexhep Elmazi, poet nga Gjilani. Mirëpo, pak ditë para se ta dorëzoi në shtyp, UDB-a bën arrestime të shumta kudo në Kosovë. Në Gjakovë, pos të tjerëve, arrestohen shokët e tij letrarë: Teki Dervishi e Sefedin Fetiu, si anëtarë të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, (LRBSH), të cilën e udhëhiqte, patrioti Adem Demaçi, e ky bënte pjesë edhe Esati. UDB-a e thërret Esatin disa herë në procedim. Nga frika se nuk mund ta përballojë dhunën e hetuesve, vendos që të arratiset në Shqipëri, ku e vijoi shkollimin në Institutin e Teknikës në Tiranë, dhe mori titullin e Inxhinierit të makinerisë. Shumë vite punoi në Kombinatin e Metalurgjisë, në Elbasan. Tani jeton dhe punon përkohësisht në Gjakovë, por edhe në Elbasan.

„Ngjyrat e jetës“ janë gjithsejt 42 poezi të shkruara nga penda e një të riu, i cili nga rrethanat tashmë të njohura, nuk arriti që ta përsosë talentin e tij letrar. Në botën e pasur meditativo-poetike të Esat Cërmjanit ka plot refleksione filozofike si dhe preokupime të tilla që do t'i lakmonte secili poet i moshuar. Të bën përshtypje vargu i thukët dhe shumë mbresëlënës. Përkushtimi ndjesor i autorit ndaj të drejtës, të mirës, dhe të bukurës-është emblema e kësaj përmbledhjeje poetike, e cila, për fat të keq, po botohet pas 37 vjetësh.

Vlen të ceket se për daljen në dritë të këtij libri, meritë të madhe ka i vëllai i autorit, Muharrem Cërmjani, i cili gjatë gjithë këtyre viteve, me fanatizëm të veçantë e ruajti dorëshkrimin në fjalë. Në fund, urojmë që në të ardhmen autori të na jap edhe vepra tjera.

Kryeredaktori i „DRITËS“ : Shefki Oseku